




REPUBLIKA E KOSOVës - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-2085/2012
Nr. Prot. 02	Data 13-06-2012
Nr. pages 02	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-5083/11,për, z.Sylejman Metushin, Drejtor i Spitalit Regjional-Ferizaj, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli, AKK– 03-5083/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë z.Sylejman Metushin, Drejtor i Spitalit Regjional-Ferizaj, ku është dyshuar për ushtrimin e dy funksioneve ne te njëjtën kohë gjatë ushtrimit te Funksionit Publik si Drejtor i Spitalit Regjional ne Ferizaj dhe si person i autorizuar ne Biznesin private N.Sh. “ALDONEI”-Ferizaj

Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit te gjendjes është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, pasi qe z.Sylejman Metushin, Kirurg i punësuar pranë Spitalit Regjional-Ferizaj, nuk ushtron me Pozitën e Zyrtarit te Lartë si Drejtor i Spitalit Regjionalë ne Ferizaj qe nga data 05.04.2011,sepse i ka kaluar mandati, dhe ne këtë pozitë është emëruar një person tjetër.

Konsiderojmë se ne bazë të dëshmimeve dhe dokumentacionit të sjellë nga z.Sylejman Metushin, dhe duke vlerësuar gjendjen faktike konstatojmë se nuk ka elemente qe dëshmojnë gjendjen e Konfliktit te Interesit, pasi qe Zyrtari i Lartë nuk Ushtron me Funksionin e Zyrtarit te Lartë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

